



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 282, Datë 06.11.2025

MBI

**NJOHJEN E LICENCËS PËR TREGTIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE, LËSHUAR
NGA ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
PËR SUBJEKTIN “INTERENERGO D.O.O. – KOSOVA” SH.P.K.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 97, pika 6 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pikat 3, 4, 5 dhe 6 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016 të ndryshuar; Vendimit të bordit të ERE-s nr. 245, datë 06.12.2021 “Mbi njohjen reciproke të licencave për veprimtarinë e tregtimit dhe furnizimit të energjisë elektrike ndërmjet autoriteteve kombëtare rregullatore të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.11.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2701/5 prot., datë 03.11.2025, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, “Mbi njohjen e licencës për furnizimin me shumicë (tregtim) të energjisë elektrike, lëshuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, për subjektin “Interenergo D.o.o. – Kosova” sh.p.k”,

Konstatoi se:

- Subjekti “Interenergo D.o.o – Kosova”, degë e shoqërisë së huaj, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2701 prot., datë 22.10.2025, ka aplikuar për njohje të licencës për tregtimin e energjisë elektrike me nr. ZRRE/Li_56/16, lëshuar më 27.02.2017 dhe vazhduar më 27.02.2022 nga Zyra e Rregullatorit për Energji në Republikën e Kosovës, për subjektin “Interenergo D.o.o. – Kosova” sh.p.k.
- Me e-mailin e protokolluar me nr. 2701/1 prot., datë 28.10.2025, ERE paraqiti pranë Zyrës së Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës (ZRRE) kërkesën për informacion në lidhje me vlefshmërinë e kësaj licence dhe në rast se kjo zyrë ka ndërmarrë ndonjë veprim për heqjen apo pezullimin e kësaj licence.
- Në përgjigje, me e-mailin e protokolluar në ERE me nr. 2701/2 prot., datë 28.10.2025, ZRRE ka njoftuar se nuk ka ndërmarrë ndonjë vendim për heqjen apo pezullimin e kësaj licence.
- Nga shqyrtimi paraprak i aplikimit, ka rezultuar se autorizimi i përfaqësimit është depozituar në formatin fotokopje, ndaj ERE i është drejtuar shoqërisë me e-mailin e protokolluar me nr. 2701/3 prot., datë 28.10.2025, duke i kërkuar që, brenda 2 (dy)

ditëve, të depozitohet këtë dokument në ERE në formatin origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2701/3 prot., datë 28.10.2025, shoqëria ka depozituar autorizimin përkatës në format origjinal.
- Subjekti ka kryer pagesën e aplikimit për njohjen e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe ka depozituar në ERE të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga neni 4, pika 3 dhe shtojca 1/K e *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”*, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar.
- Afati i njohjes së licencës do të jetë i njëjtë me afatin e licencës së lëshuar nga ZRRE, për shoqërinë “Interenergo D.o.o. – Kosova” sh.p.k, deri në datën 27.02.2027.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë njohjen e licencës për tregtimin e energjisë elektrike, me nr. ZRRE/Li_56/16, lëshuar më 27.02.2017 dhe vazhduar më 27.02.2022 nga Zyra e Rregullatorit për Energji në Republikën e Kosovës, për subjektin “Interenergo D.o.o. – Kosova” sh.p.k, që ka regjistruar në Shqipëri subjektin “Interenergo D.o.o – Kosova”, degë e shoqërisë së huaj.
2. Njohja e licencës sipas përcaktimeve të pikës 1 do të jetë e vlefshme deri më 27.02.2027.
3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “Interenergo D.o.o – Kosova”, degë e shoqërisë së huaj, OST sh.a., OSSH sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI